



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 101
Prishtinë, më 28.5.2024, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, Salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Hykmete Bajrami, Arta Bajralija, Bekim Arifi, Halil Thaqi, Mirlinda Tishukaj-Sadiku, Visar Korencia, Albana Bytyqi, Rashit Qalaj dhe Yllëza Hoti.

Munguan: Hajdar Beqa dhe Adem Hoxha.

Stafi mbështetës i Komisionit: Antigona Ibraj.

Pjesëmarrësit e tjerë: Hajrulla Çeku, Daulina Osmani dhe Xheladin Krasniqi, MKRS, Ilir Murtezaj ATK, Myrvete Gashi Morina, Samir Zymberi, Agron Hoxha dhe Driada Thaqi, ZKA.

Mbledhjen e kryesuan: Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit dhe Arta Bajralija, nënkryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të performancës “Efektiviteti i fondeve për financimin e sportit”;
3. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. **Shqyrtimi i Raportit të auditimit të performancës “Efektiviteti i fondeve për financimin e sportit”**

Hykeme Bajrami, kryetare e Komisionit: Të nderuar të pranishëm, pika e dytë e rendit të ditës është Raporti i auditimit të performancës “Efektiviteti i fondeve për financimin e sportit”. Për ta shqyrtuar këtë raport të ftuar dhe prezent e kemi ministrin e Kulturës Rinisë dhe Sportit, z.Hajrulla Çeku. Gjithashtu e kemi edhe drejtorin e ATK-së, z.Ilir Murtezaj, sepse kanë qenë pjesë e fushëveprimit të këtij auditimi. Arsyeja pse u përfshi ATK-ja, është sepse ligji e lejon që bizneset private, deri në 30% të fitimit në tatim, ta japin si sponsorizim, për aktivitetet sportive dhe për të njëjtën shumë ato lirohen nga tatimi në fitim. Në këtë raport e kemi pa se MKRS, është pajtuar pjesërisht me gjetjet e ZKA-së. Ndërsa, ATK-ja është pajtuar me të gjeturat. Sipas ZKA-së, në këtë raport flitet edhe për ikje nga tatimi në fitim nga ana e bizneseve, sepse ka raste kur kemi sponsorizim edhe pa u pajisur me vërtetimin nga MKRS-ja. Po ashtu, nuk ka edhe raportim të mirëfilltë, ka raste kur fondet janë kthyer mbrapa tek pronaret e bizneseve. Gjithashtu, ka mungesë të mbikëqyrjes nga ana e Departamentit të Sportit në kuadër të MKRS-së për sponsorizimet në lidhje me financimet. Për ti shpalosur gjetjet në këtë raport kemi caktuar deputeten Mirlinda Tishukaj- Sadiku, të cilës ia kaloj fjalën.

Mirlinda Tishukaj-Sadiku: Siç tha edhe kryetarja, në shqyrtim sot e kemi, raportin e auditimit të performancës “Efektiviteti i fondeve për financimin e sportit”, i cili është kryer nga ZKA-ja që të vlerësojë financimin e sportit nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe nga bizneset private përgjatë viteve 2020-2022, në mënyrë që të identifikojmë dobësitë, dhe fushat për përmirësim për të garantuar transparencën, llogaridhënien dhe përdorimin e duhur të fondeve. Pjesë e fushëveprimit të këtij auditimi ka qenë Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), Administrata Tatimore e Kosovës ATK. Në kuadër të Ministrisë ka qenë Departamenti i Sportit dhe Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për vërtetimin e sponsorizimit në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Nga ATK-ja janë shfrytëzuar të dhënat lidhur me lirimin nga tatimi i bizneseve të cilat japin sponsorizime për sport. Në këtë raport. ZKA-ja ka identifikuar disa gjetje siç janë:

- Strategjia për zhvillimin të sportit ende e pa aprovuar, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk ka arritur të hartojë strategji për zhvillimin e sportit, duke rezultuar në mungesë të drejtimit në zhvillimin e sportit në Kosovë. Praktikant me të cilat vepron Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit për subvencionimin dhe lejimin e sponsorizimeve të kompanive private për organizatat sportive, nuk ofrojnë qëllime të qarta për shfrytëzimin e fondeve. Për më tepër, ekziston një mungesë e dukshme e dëshmimeve që vërtetojnë se këto kontribute financiare, në mënyrë efektive kanë përmirësuar cilësinë e sportit në Kosovë.

Gjetje tjetër është: Përdorimi i sponsorizimit për fushatë marketingu të kompanive private. ZKA-ja ka hasur në raste ku disa sponsorizime janë bërë me qëllim ekskluziv të marketingut për sponsorët – gjë që dëshmon se një pjesë e këtyre fondeve nuk po shpenzohen për aktivitete sportive, por për interes të kompanive sponsorizuese. Në një nga mostrat, një klub sportiv ka pranuar 10 mijë euro sponsorizim me qëllim të reklamimit dhe sportit (siç kanë cekur edhe në aplikacion), ndërsa nuk kishte dorëzuar raport narrativ për të treguar se sa nga ato fonde janë përdorur për reklamimin e kompanisë sponsorizuese. Në një mostër tjetër, një organizatë sportive siguroi sponsorizim prej 350 mijë euro. Gjatë fazës së raportimit, kjo organizatë ka dokumentuar një shpenzim mbi 50 mijë euro për pajisje reklamuese, për shfaqjen e reklamave sponsorizuese. Vlen të përmendet se kjo blerje, megjithëse e cilësuar si shpenzim, nuk bën pjesë në kategorinë e aktiviteteve sportive.

Gjetje tjetër është: Shpenzimi i fondeve të sponsorizimit për aktivitete josportive Në dy raste të analizuar, kompanitë sponsorizuese në kontratë me përfituesin e sponsorizimit kanë kërkuar kompensime, të cilat nuk konsiderohen interes publik siç janë bileta të udhëtimit, vip bileta për stafin e kompanisë sponsorizuese, etj. Një rast është marrëveshja me vlerë prej 350 mijë eurove, e cila është planifikuar të ndahet për një periudhë prej tre vitesh. Në këtë marrëveshje, organizata sportive është e obliguar të plotësojë disa kushte të veçanta si në vijim:

1. Ofrimi i biletave për çdo ndeshje vendore të Superligës të cilat kanë qenë bileta VIP dhe po ashtu, 50 bileta të kategorisë së parë;
2. Ofrimi i biletave për secilën ndeshje në Ligën e Kombeve dhe për kualifikuesit e Kampionatit Evropian, të luajtura në Kosovë gjegjësisht 5 bileta VIP dhe 20 bileta të kategorisë së parë;
3. Ofrimi i biletave dhe udhëtimit për secilën prej ndeshjeve të Ligës së Kombeve dhe ndeshjeve kualifikuese të Kampionatit Evropian, të zhvilluar jashtë vendit, minimum 4 bileta VIP.

Në vitin 2020, vetëm për bileta të ndeshjeve vendore, federata sportive ka shpenzuar një shumë prej 12,500 eurove për kompaninë sponsorizuese.

Gjetje tjetër është: Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) nuk ka arritur t'i identifikojë dhe gjobisë kompanitë të cilat janë liruar nga tatimi për sponsorizim e që në fakt nuk i kanë dhënë fondet për sponsorizim. Nga mostrat e analizuar në ATK, kemi vërejtur se rreth 1,573,246 euro është dëmtuar buxheti i shtetit. Në këtë vlerë hynë 490,347 euro që janë liruar bizneset nga tatimi dhe këto fonde nuk janë transferuar në klube, ndërsa rreth 1,083,246 euro, bizneset kanë sponsorizuar klubet pa u pajisur me vërtetim nga MKRS-ja. ATK-ja nuk ka ofruar ndonjë informacion nëse kishte gjobitur ndonjë kompani për shkelje të tilla. Por, pas diskutimeve tona gjatë auditimit me zyrtarët e ATK-së për parregullsitë e identifikuar, ATK-ja ka gjobitur dy kompani për mosdeklarim të saktë të tatimeve. Kontrolli ju është referuar kompanive të cilat kishin deklaruar zbritje në tatim, pa u pajisur me vërtetim nga MKRS-ja.

Gjetje tjetër është: Financimi i përfaqësuesve të Federatave sportive është përcjellë me mangësi. Federatat sportive në Kosovë nga viti 2020 deri me 25 tetor 2022 nuk kanë qenë të licencuara. Ato kanë filluar të licencohen me radhë nga data 25 tetor 2022. Edhe pse federatat nuk kanë qenë të licencuara dhe nuk kanë pasur të drejtë të zhvillojnë aktivitetet sportive dhe të financohen nga MKRS-ja apo sponsorizimi, MKRS-ja ka financuar këto federata edhe gjatë kësaj periudhe kohore. Bazë për këtë financim është marrë vendimi i ministrit i datës 30.4.2021, për vazhdimin e vlefshmërisë së licencave të federatave sportive.

Gjetje tjetër është: Financimi i organizatave sportive, nuk është i rregulluar qartë Gjatë analizimit të mostrave për vitet 2020-2022, kemi vërejtur se organizatat sportive marrin subvencion shumë herë më të lartë se sa kanë merituar në bazë të pikëve të bazuara në rregullore për kategorizimin e federatave sportive. Nga llogaritja e diferencës ndërmjet shumës së cilës organizatat sportive kanë merituar në bazë të pikëve të fituara dhe financimit real gjatë vitit 2020, shihet se ka një dallim për 805,498 € më shumë se sa organizatat sportive që e kanë merituar në bazë të kriterëve. Për vitin 2021 (aneks tabela 10) organizatat sportive janë financuar në shumën rreth 1.4 milion euro më shumë se sa kanë merituar në bazë të pikëve. Po ashtu, gjatë këtij viti ka raste kur federata me aneks memorandum ka përfituar 6 herë më shumë subvencion se sa ka merituar. Gjatë vitit 2022

(aneks tabela 11) organizatat sportive janë financuar rreth 582,370 euro më shumë se sa kanë merituar në bazë të pikëve.

Gjetje tjetër është: Avancet e pambyllura të federatave dhe klubeve sportive të cilat kanë përfituar në vitin 2020-2022 Nga vlera e përgjithshme e financimit e cila për vitin 2020 ishte 4.1 milion euro për organizatat sportive, rreth 1.2 milion euro, apo 39 organizata sportive nuk kanë raportuar në MKRS, se si i kanë shpenzuar këto fonde publike dhe për çfarë qëllime i kanë shpenzuar. Po ashtu, nuk kanë raportuar për rezultatet e arritura, edhe pse ligjrisht ishin të obliguara që të raportojnë me së largu deri në fund të vitit 2020. Nga analiza e 17 mostrave të vitit 2020, 10 organizata sportive të cilat kanë përfituar në vitin 2020, nuk kanë raportuar në MKRS dhe kanë përfituar sërish në vitet tjera 2021 dhe 2022. Po ashtu, këto 10 organizata sportive, avancet e përfituara figurojnë të hapura edhe në vitin 2022. Nga 39 mostrat e analizuara për vitin 2021, 10 organizata sportive kanë përfituar edhe në vitin 2022 edhe pse përfitimin e vitit 2021 nuk e kanë të mbyllur avancën. Po ashtu, nga 39 përfitues të vitit 2021, 22 prej tyre kanë avance ende të pambyllura prej vitit 2020. Përveç financimeve të federatave me memorandume MKRS-ja në vitin 2021 ka financuar klubet sportive me thirrje publike. Ne kemi analizuar gjashtë mostrat dhe kemi vërejtur se të gjitha këto janë avance të pambyllura. Vlera e tyre ishte në shumë prej 217,809 euro. Vlera e përgjithshme e financimit të MKRS-së për organizatat sportive për vitin 2022 ka qenë 5.2 milion euro. Nga kjo vlerë, 2 milion euro janë avance të hapura dhe nuk janë të raportuara në MKRS.

Keqmenaxhim i projektit data-baza sportive e Kosovës Përmes shpalljes publike të MKRS-së në dhjetor 2021 një OJQ kishte përfituar subvencion në vlerë prej 121,430 euro për zhvillimin e projektit “Data baza Sportive e Kosovës”. Këtë projekt përfituesi duhej ta realizonte brenda gjashtë muajve, përkatësisht deri më 30.6.2022. Ministria produktin në fjalë nuk e ka pranuar përmes komisionit për të vlerësuar nëse produkti i përmbush objektivat e parapara dhe rrjedhimisht avanci për këtë subvencion është ende i hapur. Në dosje, kishte dëshmi se MKRS-ja kishte refuzuar ta mbyllte avancën për këtë projekt për shkak të paqartësisë rreth cilësisë së projektit. Për më shumë, edhe në vlerësimin e aplikacionit për subvencionim ishte e nënshkruar vetëm nga njëri anëtarë i komisionit. Duke marrë parasysh që Ministria nuk e ka shfrytëzuar as shqyrtuar raportin final të përfituesit edhe pas afër 9 muajve, për të cilin kishte paguar 121,430 euro, tregon për keqmenaxhimin e të gjithë procesit lidhur me këtë subvencionim dhe rrjedhimisht mos arritje të vlerës për parandë e shpenzuar.

Çështje tjetër: Mungesa e monitorimit të fondeve të subvencionuara dhe sponsorizuara MKRS-ja nuk ka sistem i cili verifikon apo vërteton se aktivitetet e subvencionuara arrijnë qëllimet e tyre dhe realizohen. Nga mostrat e analizuara, përveç që një pjesë e madhe e organizatave sportive nuk raportojnë, ato të cilat raportojnë përgatitin një raport narrativ i cili është shumë i thjeshtë dhe nuk përmbajnë dëshmi shtesë. Një e gjetur tjetër nga ZKA-ja, po ashtu, nuk ka koordinimi ndërmjet Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Administratën Tatimore të Kosovës për të cilën është e nevojshme të kemi sqarime. Në bazë të këtyre, të gjetura nga ZKA-ja janë dhënë 10 rekomandime, prej tyre: gjashtë (6) rekomandime për MRKS-në dy (2) rekomandime për ATK-në dhe dy (2) rekomandime për MKRS-në dhe ATK-në. Ministër me disa të gjetura nuk je pajtuar dhe nëse ke mundësi të na japësh një përmbledhje.

Hajrulla Çeku: Faleminderit kryetare, përshëndetje për të gjithë. Ky raport i ZKA-së vjen paralelisht me disa procese të tjera në kuadër të angazhimit tonë për plotësim ndryshimin e ligjit

për sponsorizim në vitin 2023 në komunikim me ZKA-në. Kemi kërkuar të bëhet një auditim i veçantë. Në vitin 2020 nga lista e sponsorimit kemi identifikua, por ka qenë një listë e dyshimeve mbi shumën e sponsorizimit. Shqetësimet tona i kemi bartur në Policinë e Kosovës për dyshimet e bazuara. Procesi i tretë është duke u shqyrtuar nga Komisioni Parlamentar për Sport, vitin e kaluar ka nisur vlerësimin e zbatimit të ligjit të sponsorizimit. Këto procese do të na ndihmojnë ta nisim procesin e plotësimit-ndryshimit të ligjit për sponsorizime. Ne kemi komunikim intensiv me ZKA-në. Ne i kemi adresuar të gjitha rekomandimet. Mospajtimet tona kanë të bëjnë me kualifikimet që kanë të bëjnë në gjuhë e raportit. Prioritet ka qenë rritja e organizimit të aktiviteteve ndërkombëtare sportive në vendin tonë. Programi Kosova shteti i xhudos ku janë bërë bashkë 7 ministri dhe është hartuar programi shtetëror dhe ka implikuar financim shtesë.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Kur flitet të financimet shtesë, dhe ZKA-ja i referohet si financim i pamerritur, aty flasim për kategorizim dhe për caktim të koeficientit nga ana e Ministrisë së Kulturës, ku ZKA-ja e thotë se MKRS-ja është vonuar disa herë për caktimin e koeficientit. Ndërkohë ju thotë se mbështetja e shtesë, një prej formave është siguruar për pjesëmarrjen në aktivitetet ndërkombëtare dhe një mostër që analizon ZKA-ja flitet për një projekt ku MKRS-ja ka dhënë 30 mijë euro dhe 20 mijë euro kanë shkuar në gjurmim të dheut të fushës dhe ju e keni kualifikuar të nevojshme për përgatitjen e terrenit. Përse MKRS-ja ka nevojë të kontraktosh një organizatë joqeveritare për të bërë një data bazë të sportit, ku keni zyrtarë të cilët janë në gjendje për ta bërë këtë data bazë?

Hajrulla Çeku: Nuk ishte fjala për pjesëmarrja në aktivitetet ndërkombëtare, por si objektiv për organizimin e ngjarjeve ndërkombëtare sportive në Kosovë, i cili është prioritet në programin tonë dhe si e tillë ka një proces i cili duhet zbatohet dhe kjo e kërkon gjithmonë mbështetjen e shtetit, siç kanë ndodhur në rastin e të drejtës së fituar për mikpritjen e Lojërave Mesdhetare 2030 në Kosovë, dhe kemi inkurajua federatat. Kur vendoset koeficienti dhe ndahet buxheti vjetor që është i domosdoshëm për funksionimin e federatave, nëse mbetet vetëm në ato federata funksionojnë në nivel minimal. Rritja e buxhetit për sportin është lajm i mirë dhe ky financim të jetë sa më meritore. Jam dakord me ju se data baza duhet të realizohet në kapacitetet e brendshme, proces i rëndësishëm me të cilat na duheshin të dhëna për procesin e hartimit të strategjisë për sportin. Ju ftoj që të bëhet vlerësimi i data bazës që është implementua. Për herë të parë në Kosovë e kemi një sistem të konsoliduar të të dhënave që na tregojnë saktësisht numrin sportistëve, sporteve, rajoneve dhe shumë parametra tjera të domosdoshme për planifikim të zhvillimit më tutje.

Hykmete Bajrami, kryetare e Komisionit: Z. ministër kur flitet për rezultatet, prej 119 mostrave të auditorit, 55 federata nuk kanë paraqitur rezultate dhe ata kanë vazhduar edhe në vitet vijuese të marrin sponsorizim. Këto federata nuk kanë raportuar për vitin 2011, të njëjtit janë përfitues në vitin 2022 ose nuk kanë raportuar në vitin 2020 dhe është përfitues në vitin 2021 dhe 2022, kemi nevojë për sqarime për këtë çështje. Kanë marrë sponsorizim nga bizneset, pa pasur vërtetim nga ana e MKRS-së, në anën tjetër kanë vazhduar financim edhe prej MKRS-së.

Hajrulla Çeku: Nëse nuk e kam marrë vërtetimin nga MKRS-ja, ai nuk është sponsorizim. Bizneset dhe organizatat sportive kanë mundur të zhvillojnë edhe marrëveshje dhe transaksione në mes veti por nëse nuk e ka vërtetimin nuk i përfiton lehtësitë që i jep ligji.

Hykmete Bajrami: Problemi është se ATK-ja i ka kualifikua si sponsorizim dhe ja ka zbritur në tatim. Nuk duhet lejuar të bëhen keqpërdorime të tilla.

Hajrulla Çeku: Rastet e tilla kanë mënyrën e adresimit. Por, asnjë nga palët nuk është përfitues i beneficioneve sepse nuk ka certifikatë të lëshuar nga MKRS-ja, vetëm momentin që lëshohet vërtetimi nga MKRS-ja llogaritet të jetë i ligjshëm. Kur flasim për raportime, janë 1000 të lëshuara në vjet, një vëllim mjaft i madh të punës të cilat deri tash i ka kryer vetëm një komision në MKRS në bazë të rregullores së vjetër. Një pjesë e konsiderueshme të rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit, tashmë janë adresuar në rregulloren e re të sponsorizimit. Sot e kemi nënshkrua rregulloren e re, e cila i adreson rekomandimet nga ZKA-ja.

Të gjitha aktivitetet të sponsorizuara dhe subvencionuara duhet të jenë të bazuara në strategjinë për sport e cila garanton ngritjen e cilësisë së sportit në vendin tonë. Ne kemi thënë se Kosova e ka një plan kombëtar të zhvillimit, program i cili është i detajuar dhe kemi pas një bazë strategjike të orientimit. Teknikisht, ZKA-ja ka të drejtë kur thotë se MKRS-ja nuk ka një dokument i cili quhet strategjia e sportit, por nuk kemi vepruar pa një udhëzim strategjik të veprimit.

Hykmete Bajrami: Problemi qëndron se ZKA-ja dhe komisioni juaj kur bën matjen e rezultateve, e ka të vështirë bërjen e matjeve të objektivave sepse nuk ka një dokument të cilit i referohesh edhe thua sipas kapitullit 15.5, këtu kanë qenë objektivat, dhe Departamenti i Sportit kur i jep vërtetimin për sponsorizim thotë se ne në bazë të këtij objektivi, pastaj i njëjti komision i cili dhe i lëshon vërtetimet, bën vlerësimin, por nuk dihet se cili dokument i referohet.

Hajrulla Çeku: Nga ZKA-ja është thënë se matja e zhvillimit të sportit si bëhet nuk e keni dokument për matjen e performancës, çfarë arrihet me sponsorizime, subvencionime, çka përfiton shoqëria etj. Njëra ndër dokumentet me të cilat ne punojmë quhet PSO (Plani Strategjik Operacional) i Qeverisë dhe i secilës ministri. Përfshihen objektivat e përgjithshme deri tek indikatorët matës të secili aktivitet në raport me impaktin. Rekomandimi i dytë thotë: që gjatë aplikimit të organizatave sportive për vërtetim të sponsorizimit, forma e aplikacionit ndërmjet sponsorit dhe organizatës sportive duhet të jetë më e detajuar në aktivitetet dhe të pranohen nga MKRS-ja vetëm aktivitetet të cilat paraqesin interes publik për zhvillimin e sportit në vend. Ligji nuk e detajon interesin publik që të udhëzojë punën e komisioneve për definimin e saktë. Ky rekomandim i raportit është adresuar me nenin 7 paragrafi 1.9 të rregullores së re e cila është miratuar. Rekomandimi i tretë thotë: të ketë formë të standardizuar të raportimit të sponsorizimit nga organizatat sportive dhe të pranohen vetëm fondet të cilat janë shpenzuar për aktivitetet sportive dhe të cilat do të zhvillohen në të ardhmen dhe ky rekomandim është adresuar me nenin 14 paragrafit 2 të rregullores së re të sponsorizimit.

Rekomandimi i katërt: MKRS-ja duhet të sigurohet që komisioni i vlerësim të aplikacioneve për vërtetim të specializimit dhe komisionit për pranim të raporteve të sponsorizimit, të mos kenë konflikt të interesit dhe për të siguruar paanshmëri me rregulloren që është miratuar sot nenit 8 e themelon komisionin për shqyrtim të kërkesave, 12 komisionin e ankesave dhe neni 15 komisioni për mbylljen.

Rekomandimi numër pesë: Te subvencionet kur nuk e raporton detyrohesh ta kthesh diferencën, ndërsa te sponsorizimet neni 14 paragrafi 4 thotë se nëse nuk e mbyllin ata nuk mund të jenë përfitues të sponsorizimeve të reja.

Rekomandimi i gjashtë: Neni 18 paragrafi 1.4 i rregullores së re, shprehimisht e detajon mënyrën e monitorimit të aktiviteteve.

Rekomandimi i shtatë: është për ATK-në, njëjtë dhe rekomandimi numër tetë, nëntë dhe dhjetë.

Hykmete Bajrami: Z. ministër ju përgëzoj për hartimin e rregullores, por ne jemi duke shqyrtuar një raport të vitit 2021-2022 dhe sponsorizimet e vitit 2021-2022. 80%, u fol se çfarë do të bëhet tash e tutje pas nënshkrimit të rregullores së re, ndërkohë nuk besoj se ju e keni pasur pengesë vetëm një rregullore për adresimin e të gjeturave të auditorit ndër vite sepse nëse dikush nuk ka raportuar në MKRS, duke e potencuar se prej 119 mostrave, 55 prej tyre nuk kanë raportuar objektivat dhe kanë vazhduar të jenë përfitues të subvencioneve, komisionet dhe vetë ministria është do duhej të merrte masa ndaj tyre. Fjalën e kaloj tek znj. Myrvete Gashi nga ZKA-ja.

Myrvete Gashi- Morina: Faleminderit, një sqarim për mospajtimet e ministrit që kishte me gjetje tona. Të dy gjetjet tona qëndrojnë, domethënë këto nuk kemi të bëjë me fjalë meritore ose jomeritorë, gjetjet janë shumë të drejtpërdrejta. Gjetja e parë ka të bëjë me financimin e federatave sportive me licencë të skaduar, këtu çështja është shumë e thjeshtë, ka licencë ose nuk ka licencë, në këtë rast nuk ka pasur licencë nga viti 2020, deri në vitin 2022, jo të gjitha federatat sportive kanë pasur licencë. Në këtë rast MKRS-ja ka financuar në mënyrë të jashtëligjshme federatat sportive. Nuk mjafton vetëm rregullorja pasi duhen ndërmarrë hapa konkretë, në veçanti monitorimi sistematik.

Hajrulla Çeku: Faleminderit auditore, pajtohem se monitorimi është i rëndësishëm dhe duhet rriten kapacitetet. Sa i përket licencimit një herë është bërë një zgjatje e afatit të licencës për të gjitha federatat sepse kemi qenë duke hartuar rregulloren e re. Ndërsa financimi pa licencë, në momentin që është miratuar rregullorja e re për licencim dhe është hap afati për licencim të federatave, ka qenë situatë e cila është paraqitur nga vetë komuniteti sportiv në Kosovë. Pa licencë nuk ka financim, shumica e federatave kanë qenë në proces të pajisjes me licenca. Shpresoj që ligji i plotësuar i sponsorizimit të hyjë në përdorim këtë vit, aty kemi nevojë për një debat më të gjerë.

Hykmete Bajrami: Nuk e di përse bizneset duhet me i sponsorizimi sportin me mjete të shtetit dhe ta shfrytëzojnë për materiale reklamuese, bileta VIP, akomodim në hotele dhe bileta aeroplani, këto janë të gjetura nga ZKA-ja. Ligji nuk i ka parapa këto gjëra të cilat kanë ndodh përgjatë viteve. Në qoftë se ne duhet të sponsorizojmë sportin dhe pajtohem si institucione është mirë që bizneset të paguajnë tatimin aty ku duhet dhe pastaj të rritet buxheti i MKRS-së dhe krahas saj të rritet dhe stafi për monitorimin dhe shpenzimin e këtyre fondeve.

Në faqen 4 të raportit thuhet që sponsorizimet nga biznesi në vitin 2020 janë 2.3 milion euro, në vitin 2021 janë 7 milion euro, në vitin 2022 është 9.5 milion euro. Në faqen 7, ZKA-ja ka paraqitur hapat se si një biznes mundet të lirohet nga tatimi në ATK për hirë të sponsorizimit që ju bëjnë federatave të ndryshme, ku thotë se organizatat sportive e gjen biznesin që dëshiron për t'ia bërë sponsorizimin e aktivitetit, pastaj pas marrëveshjes me biznesin shkon në MKRS, në Departamentin e Sportit me vërtetim dhe me plan të aktiviteteve dhe ai plan miratohet, i lëshohet vërtetimi me të cilin ajo ka të drejtë të lirohet nga tatimi në ATK, disa raste sipas të gjeturave të auditimit. DS nuk e di nëse kanë aplikuar sepse Zyra Kombëtare auditimit, ajo çka kanë gjet është që ka raste kur kemi sponsorizim nga ana e bizneseve pa vërtetim nga DS, respektivisht MKRS. Ndërkohë mandej janë aplikuar si zbritjet tatimore në administratën tatimore dhe flasin për dy raste

të gjobave pasi që ZKA-ja e ke ngritur dhe e ka bërë këtë debat. Na thoni ju lutem se çfarë masa keni ndërmarrë dhe a ka rastet e tilla ku edhe sot edhe çka po ndërmerrni për ose e tjera, domethënë që bizneset janë liruar prej tatimit për në fakt nuk i kanë përcjellë të gjitha vërtetimet? Si ka mundësi që një biznes në administratën tatimore të Kosovës me u lirua nga tatimi, pa e sjellë vërtetimin nga ana e MKRS-së sepse kjo thjesht i bije evazion fiskal në pajtueshmëri me Administratën Tatimore të Kosovës, kjo është sikur ATK-ja pajtohet që të ketë evazion fiskal, përndryshe domethënë cilit do bizneset që shkon për të aplikuar për çfarëdo lirimi besoj që ju keni procedurat e qarta dhe kërkoni që me çfarë baze ai po kërkon lirim nga tatimi këto janë të gjeturat me të cilat ju jeni pajtuar. Na tregoni saktë çka po bëhet sot edhe çfarë është bërë me këto raste? Zyra Kombëtare Auditimit nuk i ka audituar të gjitha rastet e sponsorizimeve. ZKA-ja funksionon në mostra d.m.th. nëse keni pasur 1000 raste të sponsorizimeve atëherë ata kanë marrë 10% prej tyre, mirëpo, ju keni obligim që me ju kthyer të gjitha rasteve nëse i kanë vërtetimet dhe të ndërmerren masa në mënyrë që dikush mos ta shfrytëzojë Ligjin për sponsorizim të sportit. Drejtor i ATK-së fjala është për ju.

Ilir Murtezaj: Faleminderit kryetare, ATK është institucion që shumicën e proceseve të punës i ka të digjitalizuar dhe aktivitetet e saj janë në mbikëqyrje të deklarimeve dhe pagesës së tatimeve nga ana e aktivitetit të bizneseve janë 100% të bazuara në sistemin elektronik. ZKA-ja ka bërë punë jashtëzakonisht të mirë ku kanë identifikua të gjetura, sigurisht që janë evidente edhe pajtimi jonë ka qenë në harmoni me të gjeturat, por nuk pajtohem me kryetaren e komisionit znj. Bajrami kur tha se me miratimin e ATK-së lejohet evazoni fiskal. Sistemi elektronik i ATK-së, deklaratat nga ana bizneset dorëzohen në mënyrë elektronike edhe dizajnimi i tyre biznesi raporton: të hyrat, shpenzimet dhe fitimet. Bazuar në Ligjin mbi sponsorizime dhe Ligji mbi tatimet të korporatave është lejuar që deri në 30% të tatimit të detyrueshëm bizneset të mund ta japin si sponsor te organizatat biznesore. Ato lëndë të cilat nuk i kanë përmbush kriteret me ligj të sponsorizimit janë refuzuar, dhe të i kthejnë mjete, të paguajnë tatimin që nuk e kanë paguar. Dy rastet të cilat u përmendën, por edhe të gjitha rastet e tjera janë kthyer mjetet sepse gjoba është e ndaluar me ligj.

Mirlinda Tishukaj-Sadiku: Unë po citoj vetëm konstatimin nga ZKA-ja: Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) nuk ka arritur t'i identifikojë dhe të ndërmarrë masat ligjore ndaj kompanive të cilat janë liruar nga tatimi për sponsorizim dhe të cilat nuk i kanë dhënë fondet për sponsorizim. Keni pasur mundësi për një periudhë njëmuajore t' i kundërshtoni këto të gjetura sikur MKRS.

Ilir Murtezaj: Ne kemi ndërmarrë veprime të 26 raste të konstatuara mbi 1 milion euro.

Mirlinda Tishukaj-Sadiku: Z. Murtezaj përse është dashur të pritet ZKA-ja për t' ju treguar se si është gjendja, përse nuk keni ndërmarrë hapa më herët për këtë çështje, sepse është një shumë mjaft e madhe.

Ilir Murtezaj: ATK-ja punë primare e ka luftimin e informalitetit, kjo rritje e të hyrave në raport me rritjen e GDP-së, mbi 16% dëshmon se ka rritje të informalitetit.

Hykemte Bajrami, kryetare e komisionit: Në momentin kur biznesi hyn edhe deklarohet dhe përmendet sistemin elektronikë, ju tha se e marrim të mirëqenë, domethënë në qoftë se ai e mbush kolonën që e ka sponsorizu një federatë. A kontrolloni për secilin biznes kur ka raste të sponzozimit dhe kërkesë për lirim nga tatimi, a ka sistem i cili kontrollon, a ka vërtetim nga MKRS-ja dhe a bëni kontrollë në MKRS në qoftë se ajo do e kishte lejuar?

Rekomandimi im është, se nuk duhet të merret si e mirëqenë ku mundeni të bëni ndërhyrje ne sistemi, dhe është dashur që një vërtetim të tillë të bëhet upload apo të ngarkohet nga MKRS-ja. A kemi raste të tilla? Nga ZKA-ja janë konstatuar raste ku ka pronarë të federatave të cilët janë pronar dhe të bizneseve, dhe ky duhet me qenë konflikt i interesit. Na tregoni z. Murtezaj a ka raste kur dikush pa vërtetim lirohet nga tatimi, sepse nëse mostra është 10%, i bie se dëmi buxhetor mund të jetë më i madh.

Illir Murtezaj: Mostra nuk është 10%, po është mbi 50% sepse në vitin 2020 kemi pas 201 raste të cilat kanë dhënë sponsorizim, në vitin 2021 kemi 427 raste dhe në vitin 2022 kemi pasur 556 raste. Mbi 300 raste, u tha se janë identifikuar të gjetura. Sistemi elektronik është i dizajnuar në atë formë kur deklaratën e proceson në atë formë si e deklaron tatimpaguesi, pritet ATK-ja të bëjë pastaj verifikimin.

Hykemte Bajrami: Nëse kemi hapësira të tilla për keqpërdorime nga ana e bizneseve është më mirë të financohet drejtpërdrejt nga shteti, ne kemi marrë modele nga vendet e zhvilluara, ku me ligj të sponsorizimeve është ndihmuar zhvillimi i sportit dhe biznesi, në mënyrën e reklamimit. Ia kaloj fjalën auditorës.

Myrvete Gashi Morina: Kemi marrë 45 mostra në ATK, ku prej këtyre mostrave kemi krahasuar listat në MKRS dhe listat në ATK, kanë rezultuar se 352 biznese kanë qenë të liruara nga tatimi më shumë në ATK, se që kanë qenë në listat e MKRS-së, domethënë kjo është ajo diferenca.

Hykemte Bajrami: Z. Murtezaj, 352 biznese pa pasur dëshmi të mjaftueshme nga ana e MKRS-së janë liruar nga ATK-ja. Shifrat flasin vetë, ku prej 1000 mostrave, vetëm 45 janë analizuar.

Yllëza Hoti: Faleminderit kryetare. Kërkesa për një sistem më të mirë për ATK-në, që të jap mundësinë të detektojë ato biznese të cilat nuk kanë vërtetim nga MKRS-ja, pajtohem me atë çfarë tha kryetarja. Në këtë rast a është dhe opsioni që bizneset të paguajnë fillimisht të gjitha tatimet dhe pastaj të rimbushen me këtë rast bizneset kanë më shumë iniciativë për t'i sjellë dokumentet për rimbursim?

Illir Murtezaj: Po, shtë opsion, sikur të krijohet baza ligjore. Ligji aktual e ka parapa në atë formë që drejtpërsëdrejti mund të jepen mjetet 30% që i takojnë.

Hykemte Bajrami, kryetare e komisionit: Baza ligjore kërkon që për t'u liruar prej tatimit më pas vërtetimin prej MKRS-së, është e thjeshtë, domethënë 352 biznese kanë pasur mospërputhje ose nuk i kanë pasur ato vërtetime të ngritura nga MKRS-ja.

Hajdar Beqa: Faleminderit kryetare, përshëndetje për ju të gjithë. Vlen të falënderohet ZKA për një pasqyrim të drejtë të gjendjes së sponsorizimit të sportit. Duhet të jemi të vetëdijshëm për ligjin për sponsorizim, i cili ka hy në fuqi më 17 janar 2017, është ligj i avancuar. Ne po shohim se problemi nuk është tek ligji, por në mënyrën e rritjes së kontrollit nga MKRS-ja, për shfrytëzimin e sponsorizimit me qëllimet të cilat kanë aplikuar. Mendoj se klubet sportive nuk kanë qenë në gjendje të mirë dhe ligji ka bërë favor. E drejtë është të thjeshtësohet procedura e sponsorizimit dhe rritja e kontrollit nga MKRS-ja dhe ATK-ja. Shtetet rajonale kanë ligje të ngjashme që i sponsorizojnë, andaj esenca është krijimi i mekanizmave për rritje të kontrollit. A qëndron problemi i mospasjes së strategjisë MKRS të paaprovuar? Vetëm në këto mostra bazuar në raportin e ZKA-së vetëm 1 milion euro është dëmtuar buxheti, duhet shikohet më mirë nga ATK-ja se si në fakt qëndron situata në bazë të kontrolleve.

Hajrulla Çeku: Jam dakord se duhet diskutuar kjo çështje dhe gjetjen më praktike, por ligji të paktën ka nevojë për një plotësim-ndryshim dhe ai proces na dërgon tek përgjigjet përfundimtare, se cila është rruga më e mirë për të vazhduar.

Hajdar Beqa: A keni shiku ju si MKRS praktikat e mira rajonale apo të BE-së, ku ne synojmë të integrohemi, sepse të gjitha ligjet që kalojnë në Kuvend janë të harmonizuara me ligjet e BE-së?

Hajrulla Çeku: Po i kemi analizuar dhe përgjithësisht standardit që aplikohet në vendet e tjera është ky lloj shpenzimi mund të ketë një lehtësi tatimore në emër të marketingut, që është buxhet i planifikuar i vetë kompanisë, por nëse ai marketing është në mbështetje të sportit, që është në interes publik mund të parashihet një iniciativë të lirimit një pjesë të tatimit. Kështu si është sot, ku tatimin në fitim në vit e ke 10 mijë euro, të cilin duhet t'ia paguash shtetit deri 3 mijë euro mundesh vetë me e dërgua në sponsorizim.

Albana Bytyqi: Ajo se çfarë më bëri përshtypje në këtë raport e kemi parë se ka shumë ngecje, por një nga ngeçjet kryesore ka qenë hartimin e strategjisë, ku me sa e pash ju jeni më shumë të fokusuar në Lojërat Mesdhetare sesa në hartimin e kësaj strategjie, për mendimin tim kjo situatë nuk është në rregull. Sa keni bërë ju për promovimin e ekipeve sportive, shembull kemi ekipin e Ballkanit, i cili tri herë po shpallet kampion dhe ju nuk keni qenë në gjendje ta bëni një urim, gjithashtu kemi dhe një ekip të ri në Suharekë që është shpallur kampion dhe ka kaluar në Super ligë dhe nuk keni bërë asnjë postim. Sa jeni në gjendje të i avanconi dhe të bëni më tutje?

Hajrulla Çeku: Nuk e kuptova ndërlidhjen me temën e diskutimit dhe as me raportin e ZKA-së. Kur të doni mund të më ftoni për të ju treguar rreth postimeve të mija në rrjetet sociale.

Mirlinda Tishukaj-Sadiku: Ministër ju përgëzoj për punën e palodhshme të cilën e keni bërë deri më tani dhe vazhdoni ta bëni, a mendon se data baza ka me evitua mbikëqyrjen e shpenzimit të këtyre fondeve dhe po ashtu edhe në kuadër të ligjit për sport e ke parapa dhe agjencinë në kuadër të këtij ligji dhe a mendon se në masë të madhe do ta adresojë çështjen? U përmend dhe në raport të ZKA-së, në bazë të rregullores së MKRS-së, është e gjetur kanë qenë i njëjti komision i cili e ka leshu vërtetimin dhe i njëjti ka bërë vlerësimin e shpenzimeve të fondeve. A mendoni se kjo

hapësirë ligjore e ka krijuar këtë keqpërdorim gjatë rrugëtimit të saj? A keni një kosto të përafërt të strategjisë? Për z. Murtezaj atë se çfarë them dhe flas e ndërtojë në bazë të asaj se çka e lexoj dhe unë vetëm ju lexova konstatimin e ZKA-së. Çka nëse nuk do të ndodhte ky auditim, i cili është kërkuar nga ministri Çeku, d.m.th. do të vazhdonte me këto parregullsi? ZKA-ja a keni mundësi të na shpjegoni përse nuk jeni fokusuar vetëm në sponsorizim, jo edhe te subvencionimi?

Hajdar Beqa: Nuk jemi këtu për t'ia mbikëqyrë agjendën deputetit tjetër dhe ju lutem të mos dalim jashtë raportit nga ZKA-ja.

Hajrulla Çeku: Në lidhje me data bazën e cila është një ë gjetur, data baza ndërtohet por asnjëherë por nuk përfundon puna aty sepse duhet me qenë sistemi i cili përditësohet gjatë gjithë kohës, me këtë institucionalizim të këtij angazhimi e kemi para në ligjin e ri të sportit. Për të evituar parregullsitë. Rregullorja e re tash ka tre komisione ku efektiviteti do të jetë më i madh. Strategjia është buxhetu dhe tash është në konsultime por në raport me buxhetin e përgjithshëm të MKRS-së po i ndaj tri informata të rëndësishme: MKRS-ja është ministria me rritjen më të madhe të buxhetit në kuptim të përqindjes, krahasuar me vitin e kaluar, është 54%, kjo kryesisht për shkak të sportit. E dyta; Lojërat Mesdhetare kanë një buxhet rreth 250 milionë euro, ku 200 milionë janë investime në infrastrukturë të sportit dhe 50 milionë euro është pjesa organizative. Ndërsa sa i përket mbështetjes direkt të ministrisë, pra flasin për subvencionimin e federatave, sporteve dhe sportistëve e projekteve sportive, nga viti 2019 si vit referent ka qenë 3 milion euro mbështetja direkt, në vitin 2023 e kemi mbyllur me 10 milionë mbështetje dhe ky progres do të vazhdojë edhe viteve në vijim.

Arta Bajralija, nënkryetare e Komisionit: Fjalën e kaloj tek auditorja, znj. Myrvete Gashi-Morina.

Myrvete Gashi Morina: Sa i përket temës, kjo rrjedh prej shoqërisë civile, propozimi është bërë vitin e kaluar në qershor, auditorët kanë analizuar temën dhe auditorja e përgjithshme e ka aprovuar si temë, pas aprovimit ministri ka kërkuar takim dhe është kërkuar shtimi dhe pjesa e subvencionimit.

Halil Thaqi: Gjetja nga ZKA-ja flet rreth data bazës sportive të Kosovës, deri në dhjetorin e vitit 2021, nuk ka pasur data bazë sportive?

Myrvete Gashi-Morina: Kjo nuk është një data bazë ashtu si ju po e mendoni, kjo është një fletushkë e cila është bërë, ku janë të dhënat e të gjitha organizatave sportive. Ministri e ceku se ende ka punë për tu bërë një data bazë e mirëfilltë.

Arta Bajralija, nënkryetare e Komisionit: Nëse nuk ka pyetje të tjera brenda raportit po e përfundojmë këtë pikë të rendit të ditës.

3. Të ndryshme

Arta Bajralija, nënkryetare e Komisionit: Kemi pikën 3, ku kemi disa raporte të cilat kanë mbetur ende pa përfundim, po në mungesë të kuorumit po i kalojmë në mbledhjen tjetër të KMFP-së.

Mbledhja përfundoi në orën 13:40

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit

Hykmete Bajrami,

Kryetare e Komisionit